



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:228381

Datë: 29.01.2025

Numri i dokumentit: 06772416

KPPP.nr. 1276/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbaremore të kreditorit “Design Lifts” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810838071 dhe seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ibadete Xhafa Kuçi, avokate nga Suhareka, kundër debitorit “Hidroterm” Sh.P.K., me seli në Suharekë, Brigada 123, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Nadire Hoxha, avokate nga Suhareka, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 726/24 i datës 17.07.2024, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Liridon Tërshani, me zyre në Prizren, jashtë seancës me datën 29.01.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Hidroterm” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbaremore P.nr. 726/24 i datës 17.07.2024, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Liridon Tërshani, MBETET NË FUQI.
- II. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t’ia paguajë kreditorit shumën prej EUR 208.00 (dyqind e tetë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Design Lifts” Sh.P.K., mbi bazën e dokumentit të besueshëm: Faturës nr. 23-SHV01-001-24 e datës 25.09.2023, ka lëshuar urdhrin P.nr. 726/24 dt.17.07.2024, me të cilin e ka urdhëruar debitorin “Hidroterm” Sh.P.K., që në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, në emër të borxhit sipas faturës së lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 54,703.39 EUR (pesëdhjetë e katër mijë e shtatë e

*tre euro e tridhjetë e nëntë cent*), me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbare dhe shpenzimet e propozimit për përmbare në shumë prej EUR 208.00.

Debitori, përmes përfaqësueses së autorizuar brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhri Përmbare, me arsyetimin se urdhri përmbare është lejuar në bazë të faturës e cila nuk është në origjinal apo kopje të vërtetuar, duke mos përmbajtur nënshkrimin apo vulën e debitorit, ashtu që kushtet për caktimin e urdhrit përmbare nuk janë përmbushur. I ka propozuar gjykatës që urdhri përmbare të anulohet, si dhe të detyrohet kreditori që të kompensojë shpenzimet për përpilimin e prapësimi në shumë prej 650.00 EUR.

Kreditore, përmes përfaqësueses së autorizuar në përgjigje në prapësim ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar në dispozita ligjore dhe nuk është parashtruar për shkaqet dhe arsytet për të cilat mund të paraqitet prapësimi sipas nenit 71 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbare i përmban të gjitha elementet e përcaktuara sipas dispozitave ligjore si dhe po ashtu e njëjta është në origjinal. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbare të mbetet në fuqi, si dhe të obligohet debitori që të paguajë shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbare në shumë prej EUR 208.00, si dhe për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumë prej EUR 208.00, në shumë të përgjithshme prej EUR 416.00.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbare (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbaremi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbare po qe se në të është treguar kreditore dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbare paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 23-SHV01-001-24 e datës 25.09.2023 mbi bazën e të cilës është lejuar përmbaremi ndaj debitorit, i plotëson kushtet për të qenë dokument i

besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29, par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e biznesit të debitorit e evidentuar tek pranuesi i faturës, dhe e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë paraqet bazë për lejimin e përmbarimit pasi që është e përshtatshme për përmbarim.

Gjykata vlerësoj pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim por gjeti se nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbarimore, gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke i' a njohur shpenzimet kreditorit në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim në shumë prej EUR 208.00, në shumë të përgjithshme prej EUR 208.00, konform rregullores në fuqi për tarifatat e avokatëve, nr. tarifor 6, lidhur me shpenzimet për përmbarimet në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë 10.000,00 € e më lartë.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1276/24, datë 29.01.2025

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.